

## **STATUT I SHOQERISE TREGTARE**

**“LATERN” sh.p.k.**

### **KREU 1**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

##### **NENI 1**

Sipas kerkesave te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “ Per shoqerite tregtare” dhe ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ”, Krijohet shoqeria tregtare **“LATERN” Sh.p.k** ,e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi , nenet e ketij statuti si dhe aktit themelimit bashkengjitur tij.

### **KREU 2**

#### **EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

##### **NENI 2**

##### **Sot ne daten 28 Maj 2021**

Formohet shoqeria tregtare e emertuar **“LATERN” sh.p.k** me ortake te shoqerise :

**Z.Abaz Bajraktari** i biri i Isufit, shtetas Shqiptar, lindur ne Polican, Skrapar, me 13.03.1987 , me nr.karte identiteti I70313074J dhe banues ne Tirane, me adrese rruga Sulejman Pasha, Nd. 8/4; H.1; Ap.1.

##### **NENI 3**

Shoqeria do te kete statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin fillestar.

##### **NENI 4**

Shoqeria e ka seline e saj ne Rruga “Bulevardi Zogu i Pare”, Hyrja 2, Apartamenti 43, Njesia Bashkiake Nr.9,Tirane

Ajo mund te cel dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi e agjensi operative ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.



## **NENI 5**

Shoqëria do të ketë kohegjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet.

## **NENI 6**

Shoqëria ka vullenë e saj .

## **KREU 3**

### **OBJEKTI**

## **NENI 7**

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është : Ofrimi i shërbimeve në lidhje me ciklin e jetës së informacionit teknik dhe tregtar, përkatësisht: shërbime të menaxhimit të informacionit, redaktim teknik dhe tregtar, përkthim teknik, tregtar, ligjor dhe financiar, multimedia, shtypje dhe logjistikë; Zhvillimi dhe hedhja në treg e programeve kompjuterike dhe teknologji të tjera të lidhura me shërbimet e përcaktuara më lart. Veprimtaria e përkthimit. Projektimi i teknologjive inovative, proceseve teknologjike në fushën e ndërtimit dhe mekanikës, Konsulencë tregtare dhe organizative në të gjitha format dhe në të gjithë sektorët e aktivitetëve në Shqipëri dhe jashtë saj. Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave nëpërmjet teknologjisë së informacionit, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumenta të tjerë të marketingut të drejtëpërdrejtë. Perfaqësimin e shoqërive të ndryshme shqiptare ose të huaja që deshirojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri. Projektimi dhe dizajni mekanik dhe elektronik me mbështetje teknike për kompanitë në menaxhimin dhe zhvillimin e porositjeve brenda dhe jashtë vendit. Për të realizuar objektin e aktivitetit, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari industriale, tregtare, financiare, bankare, letrave me vlerë dhe pasuri të paluajtshme, me të drejtën e dhënies të garancive për sa kohë që është në funksion të realizimit të qëllimit të objektit të aktivitetit të shoqërisë, të ndërmarrë kuota pjesëmarrje në kompani dhe shoqëri tregtare të tjera të çdo lloji aktiviteti është analoge ose i ngjashëm dhe në çdo rast i lidhur me të aktivitetin e saj ose i cili është i dobishëm për realizimin e qëllimeve të objektit të aktivitetit të shoqërisë.

## **KAPITALI**

## **NENI 8**

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga 100 000 leke nga të cilat :

- 1- Z. Abaz Bajraktari 1- kuote e barabarte me 100 % të kapitalit.



## **NENI 9**

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te Asamblese se ortakut/eve te shoqerise, i cili nenshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bere dhe shenimet ne regjistrin perkates. Me vendim te Asamblese se ortakut/ve te shoqerise, kane te drejten qe nje pjese te kuotave te kapitalit themeltar t'ja tjetersoje nje apo disa personave fizike ose personave juridike jashte ortakerise , vendas apo te huaj mbi bazen e nje akti noterial , duke ju proceduar atyre dhe te drejten e qenies ortak ne raport me pjesen e kuotave te kapitalit te tjetersuar.

## **NENI 10**

Ortaket mund te shesin te tretteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kene marre vendimin e Asamblese se ortakut/eve te shoqeris dhe te dokumentojne kete shitje.

## **NENI 11**

Kapitali i shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera pasuri te nevojshme te luajtshme apo te paluajtshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

## **NENI 12**

Heqja dore nga shoqeria nuk e/i liron ortakun/et nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ajo gezon te gjitha te drejttat e lindura para largimit te saj.

## **KREU 4**

### **ORGANET DREJTUESE**

## **NENI 13**

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakut/eve te shoqerise .
- Administratori i shoqerise

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

## **ASAMBLEJA**

### **NENI 14**

Asambleja e ortakut/eve te shoqerise eshte organi me i larte vendimor. Asambleja merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar Pasqyrat financiare vjetor te shoqerise.



## **NENI 15**

Asambleja e ortakut/ve te shoqerise vendos per Pasqyrat Financiare vjetore , per ndryshime ne statut (100% e votave), shtimin ose pakesimin e kapitalit, per emerimin e organit administrativ, per drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, per pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqerise.

Emeron ose shkarkon administratorin e shoqerise.

Emeron ekspertin kontabel te autorizuar kur plotesohen kushtet ligjore

## **ORGANI ADMINISTRATIV**

### **NENI 16**

Administrator i shoqerise emerohet Z. Abaz Bajraktari me afat 5 -vjecar .

### **NENI 17**

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne marredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 6 te ketij statuti.

Organi Administrativ (administratori) eshte kompetent per te:

- miratuar planet dhe Pasqyrat financiare periodike mujore dhe tremujore;
- vendosur strukturen e aparatit te shoqerise;
- marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e maredhenieve te punes me ta;
- vendosur rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta), etj;
- perfaqesuar apo emeruar perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria;
- perfaqesuar shoqerine ne regjistrin e prones sipas nenit 20 te ketij statuti.

## **KREU 5**

### **KUSHTET EKONOMIKE**

### **NENI 18**

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjetet juridik ne Shqiperi ; mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim , te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj.

### **NENI 19**

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.



Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kriterëve te caktuara nga Banka e Shqiperise.

#### **NENI 20**

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin vitin e pare ne momentin e rregjistrimit ne organet tatimore, ndersa vite te tjera ne 1 Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen Pasqyrat Financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat Financiare (mujore, tremujore, gjashtemujore) miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja e ortakut te vetem te shoqerise, e nenshkruhen nga administratori.

#### **NENI 21**

Fitimi neto i realizuar, pasi jane zbritur rezervat ligjore dhe tatimet, mbetet ne perdorim ortakut(eve) te cilet vendosin per perdorimin e tij.

#### **KREU 6**

#### **MAREDHENIET E PUNES**

#### **NENI 22**

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republikën e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim , ne te kundert zgjidhja behet ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

#### **KREU 7**

#### **DISPOZITA TE VECANTA**

#### **NENI 23**

Veprimtaria e shoqerise pushon me vendim te asamblese se ortakut/eve te shoqerise per shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative
- pamundesi veprimi
- shperndahet me vullnetin e ortakut (eve).
- riorganizohet ne nje forme tjeter.



#### **NENI 24**

Ne kushtet e nenit 23 te ketij statuti , asambleja e ortakut/eve cakton nje ose me shume likuidatore te cilet marrin ne dore drejtimin e shoqerise duke kryer te gjitha veprimet e likuidimit te saj, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet ortakëve. Ndersa ne rastin e pamjaftueshmerise se kapitalit , ortaku(et) e shoqerise jane te detyruar te derdhin kuotat e tyre deri ne nivelin e kuotave te kapitalit themeltar.

#### **NENI 25**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne shoqeri me te tretet , zgjidhen me pajtim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates per zgjidhje.

#### **DISPOZITA TE FUNDIT**

#### **NENI 26**

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit themelimit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit , Tirane , ne baze te ligjit 9723 date 03.05.2007.

#### **NENI 27**

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te bejne ortaku (ete) e shoqerise si dhe ligjeve te vecanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

#### **NENI 28**

Ky statut u perpilua ne prani te ortakut/eve duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire. Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarta secila per t'u depozituar ne gjykate e per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**Ortaku i vetem i Shoqerise**

**Z. Abaz BAJRAKTARI**

